



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lizazna

Nr. -1-136

Data 18.10.2023

Br.

Datum

OBILIO-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

### KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.09.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Ali Krasniqi, nëpunës për çështje pronësore

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit
4. Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Kryesuesja** – Fillimisht i ftoi të pranishmit për një minutë heshtje në shenjë të nderimit me rastin e rënies së policit në detyrë.

Pastaj, kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

### Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

### Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

### Pika 3 e rendit të ditës

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën e DMM-së, për shqyrtimin e Planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që ky plan lokal i veprimit të shkoj për aprovim në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Në fakt pasi që edhe Ministria ka dhënë dritën e gjelbërt që të shkoj tutje, ne jemi për dhe në seancën e dt.28 nëse, kemi ndonjë vërejtje do ta japim atje. Mirëpo, gjithsesi jemi që ky dokument ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Plannit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

**Enver Gashi** – Fillimisht jemi që ky buxhet i paraparë prej Ekzekutivit ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim. Në Buxhet kanë ndodhë mrekulli sepse unë jam në mandatin e tretë dhe së pari të hyrat vetanake i kemi gjithnjë në rritje, që është një indeks shumë i mirë pozitiv. Përpara e di që linja e pagave dhe meditjeve ka pri dhe ka qenë deri në 80 % e buxhetit, ndërsa tash janë shpenzimet, ose investimet kapitale që prijnë. Uroj Ekzekutivin që ta vazhdoj këtë punë dhe buxhetet tjera, të jenë edhe më të suksesshme.

**Sami Ahmeti** – Realisht ne jemi që ky planifikim i buxhetit të shkoj në Kuvend dhe atje sigurisht se mund të kemi ndonjë vërejtje. Sa i përket asaj se tash po prijnë investimet në raport me pagat kuptohet se Obiliqi ka një diçka më të jashtëzakonshme se Komunitat tjera, për faktin se merrë një buxhet ekstra prej tantumës së KEK-ut. Prandaj, çdo gjë që bëhet për të mirën e qytetarëve ne e aplauzojmë. Në këtë buxhet ne të paktën nuk po i shohim ato pikat të cilat ju si Ekzekutivi i keni dërguar në Parlament në vitin e kaluar. Do të thotë pse, a ka qenë vetëm ndonjë shou, apo ka qenë vetëm sa për të provuar nëse nxjerrim diçka. E mirëpritur secilin prej investimeve, unë me sinjeritet e them se nuk është që e kam lexue shumë, mirëpo në seancë do të provojmë me dhënë maksimumin nëse, diçka mundemi me shtue, ose me dhënë ndonjë kontribut. Sa i përket një pike, kisha pasë dëshirë me pasë një takim edhe me drejtoreshën dhe me Komisionin i cili e ka bërë këtë buxhet. Fjala, është te shkolla në Milloshevë, po krijohet një kaos kur po dalin fëmijët prej shkollës sepse të gjitha veturat po parkohen në rrugë. Aty, pranë është një mundësi për me u bë në njëfarë forme një parking që do të mundësonte me i largue fëmijët prej rrugës dhe rrezikimin e tyre. Unë kisha pasë dëshirë nëse, ka mundësi iu kishim sjellë edhe projekt të saktë dhe e di se është vonë sepse është dashtë që këto të hyjnë më heret, por nëse diçka ka mundësi me ndryshue për hir të qytetarëve. Përndryshe, në ditën e seancës, atje do ti japim komentet tona lidhur me këtë buxhet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planifikimit të buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se pasi që e kemi dërguar materialin, ka ardhë një kërkesë nga Kreshnik Balaj dhe nëse, ju doni me shqyrtue e shqyrtojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, u pajtuan njëzërit që kërkesa në fjalë të shqyrtohet.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Kreshnik Balaj, Shkabaj sh.p.k. për zgjidhjen e problemit të pronësisë, të gjendet një mirëkuptim i përbashkët për kthimin e pronave, qoftë në tërësi, apo ato pjesore derisa të përmbushet sipërfaqja totale prej 144,286 m<sup>2</sup>. Kjo kërkesë ka ardhë me dt.12.05, që e kemi trajtuar në KPF, i kemi rekomandimet dhe procesverbalin, prandaj nuk është e vërtetë se nuk e kemi trajtuar sepse brenda afatit ligjor e kemi trajtuar. Pjesa e dytë, mua nuk po më pëlqen sepse askush nuk mundet me i dhënë vërejtje kryesueses së Kuvendit, sepse kryesuesja nuk merrë prona të askujt, as nuk jepë prona të askujt.

**Enver Gashi** – Është një kërkesë që është përsëritë këtu u cekë 3 herë, por unë e di që 2 herë dhe mendoj se DPUKP-ja, duhet të na japë një sqarim bashkë me Zyren ligjore. Unë jam për atë që kjo kërkesë të shkoj për shqyrtim në Kuvend dhe të merrë një epilog përfundimtar, e jo të mbetet në pafundësi kërkesa e tillë.

**Sami Ahmeti** – Për faktin se ka ardhë 2,3 herë dhe ne si Kuvend nuk kemi ndonjë përgjegje të saktë të Drejtorisë, nuk është bash në rregullë nga se ka qenë mirë që Drejtoria të delë me shkresë dhe të na tregon sepse edhe e kemi bërë kështu, në këtë Kuvend, që kërkesat të shkojnë në Drejtorinë përkatëse dhe ato në

Kuvend të na kthejnë një përgjegje neve e kjo bën, apo nuk bën për shkak se prekë këtë, apo atë ligj. Kërkesa që e lexuat ju, ata më shumë kishin kontest me komasacionin se sa me neve si Komunë, sido që të jetë derisa nuk kemi ndonjë përgjegje nga Drejtoritë, mendoj se duhet të veprojmë prapë njëjtë dhe me ua lënë Drejtorive që të merren me këto punë sepse e kanë kompetencën e plotë me funksionue si dhe zyra ligjore, le të nxjerrin përfundime se çka me veprue. Unë realisht nuk jam për me shkue në Kuvend sepse po e shkelim atë regullin tonë që për dikend le të shkojnë e të marrin epilog, e për dikend jo. Mendoj se derisa nuk kemi përgjegje prej Drejtorisë, ia lejmë kohën ndërsa sa i përket atij se nëse, nuk e bëni kështu unë e bëjë kështu, e konsideroj si kërcënim edhe pse mund të kenë shumë të drejtë ata që kanë halle. Mirëpo, ne si Kuvend nuk jemi për me ua rregullue problemet e tyre, me qenë krahë tyre për me mbrojtë ligjshmërinë, por jo profitet e tyre se çka kanë humbë, ose çka nuk kanë humbë.

**Arben Berisha** – Ju mundeni mos me pasë informatë dhe mund ta marrë me mend se nuk keni informatë. Kjo ka ndodhë në vitin 2012, kur ka ndodhë komasacioni dhe në atë kohë komasacioni ka qenë i formuar prej Komunës dhe Ministrisë së bujqësisë, në bashkëpunim, por në pjesën e fundit Ministria e bujqësisë, është tërheqë me një shkresë se nuk mundemi me veprue mëtutje. Pala në bazë të dokumentacionit pronën e ka ble në vitin 2009-2010, në Agjensionin në privatizim se nuk jam i interesuar me hy në çështje të komasacionit për arsye se pronat janë të mia. Ministria e ka ndalë, Komuna e ka vazhduë dhe në kuadër të kësaj dikund mbi 14 ha i ka nda në proporcion banorëve qysh ka ndodhë komasacioni. Gjykata ka ofruar edhe marrëveshje nëse, është mundësia dhe ne pa Kuvendin nuk e kemi mundësinë me veprue. Prandaj, si Ekzekutiv kërkojmë që në bashkëpunim me Kuvendin me formue një Komision të përbashkët dhe me ua sqarue edhe juve, lëndën sepse është një rrezik permanent i Komunës, se nëse Gjykata e ka ngritë padinë ndaj personave që kanë qenë në atë kohë në komasacion dhe nëse, delë këta 14 ha që ne me ua bë pagesën dhe ne e kemi rastin e Rendës më heret që ka shkue mbi 300,000 euro. Kjo vlerë është shumë e madhe dhe unë do të ua sjelli edhe propozimin me shkrim si dhe nuk është e vërtetë se ne nuk kemi reague. Mendoj se nuk ka me qenë e lehtë me krye ne këtë sepse është një vlerë jashtëzakonisht e madhe dhe vetëm nëse, e shohim fitimin e humbur që ai e paraqet qe sa vite për Komunën, do të jetë një vlerë shumë e madhe, e lëre më me ia kompensue tokën. Ne mund të hyjmë edhe në marrëveshje nëse, na lejohet që me gjetë një zgjidhje.

**Enver Gashi** – Ne në KPF dhe në Kuvend e kemi një rregullë që punojmë me rekomandime të Ekzekutivit, konkretisht të Drejtorisë tuaj. Pra, rekomandimin duhet të na sjellni në mbledhjen e Kuvendit dhe Kuvendi nuk mund të hyjë në një punë që nuk i takon Kuvendit. Ato, janë procese që kanë ndodhë shumë më heret me ose pa gabime, i cakton Gjykata më vonë dhe të gjitha Drejtoritë kur ka punë të tilla duhet ti bëjnë rekomandimet ndërsa, Kuvendi i shqyrton.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekoamnduan DPUKP-së, dhe Zyres ligjore kërkesën nr.-I-27766/2023, e dt.20.09.2023, nga Kreshmik Balaj që në mbledhjen e Kuvendit Komunal Drejtoria në fjalë si dhe Zyra ligjore të vijnë me një sqarim dhe ti njoftojnë anëtarët e Kuvendit Komunal.

**Bajram Hashani** – Pyeti për zonën kadastrale të Obiliqit, tokat që janë në komasacion si është gjendja e tyre.

**Arben Berisha** – Përgjegjet se është mirë me ardhë pala dhe me pa saktë se qysh është gjendja. Ne prona të humbura nuk kemi, por duhet me pa çështjen e bartjes së pronës sepse mund të ketë ndonjë telashe. Po ashtu, mund të jetë edhe çështja e komasacionit nuk lejon zhvillim dhe ndërtim sepse është tokë bujqësore. Fshati Mazgit, kryesisht është me këtë problem dhe ne kemi mbërri me marrëveshje dhe me pëlqimin e Ministrive përkatëse dhe sot e kemi shumicën tokë ndërtimore. Plani zhvillimor i përfshin të gjitha, por shumicën që ne e kemi pasë që është ndërtim që nga vitet e 70-ta, ato i kemi legalizue dhe i kemi bërë në formën e ndërtimit. Tani, me hartën zonale e parashohim saktësisht se si ka qenë destinacioni.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me shkresën nga Ministria e financave, punës dhe transfereve lidhur me vendimin nr.-I-120, për lejimin e faljes së tatimit në pronë. Falja e tatimit në pronë është pezulluar dhe Gjykata kushtetuese ka marrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme deri me 30 nëntor.

Të nderuar, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, asnjë vendim që merret në Kuvend nuk dërgohet në Drejtorinë përkatëse për zbatim pa konfirmim të ligjshmërisë dhe ky vendim është pezulluar. Pra, ne nuk e zbatojmë këtë vendim derisa të merret një vendim përfundimtar dhe deri atëherë ju do të njoftoheni.

**Enver Gashi** – Në këtë vendim janë 2 elemente shumë të rëndësishme, së pari Kuvendi ka veprue drejtë, por është veprimi tjetër i Gjykatës kushtetuese si instancë më e lartë, që ne deshtëm apo nuk deshtëm duhet respektuar.

**Kryesuesja** – Ky vendim nuk shfuqizohet, por duhet të presim deri me dt.30 nëntor siç ju njoftova dhe po ashtu, do ta njoftoj edhe Kuvendin.

**Sami Ahmeti** – Pikërisht, ashtu këtu nuk ka nevojë as me shfuqizue, as me marrë vendim, por vetëm pezullohet deri në fund të nëntorit, në të kundërtën ne duhet me shkue me shfuqizim. Përndryshe, jemi në rregullë me informacionin e Ministrisë.

**Blerona Shabanaj Mehmeti** – Në seancën e kaluar të muajit gusht në rend dite ka qenë edhe kërkesa e shëndetësisë për aprovimin e Planit për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025. Mirëpo, para se të votohet z.Sami Ahmeti ka bërë një pyetje rreth numrit të personave të riatdhesuar për vitin 2023. Në këtë vit janë 3 familje të riatdhesuara dhe numri i anëtarëve brenda këtyre familjeve është 6 dhe 2 familje, janë akomodue ndërsa njëra është pa akomodim për arsye se është në procedurë, do të thotë se janë afatet që secila duhet me pritë për aplikim.

**Enver Gashi** – Ne si Kuvend, kemi formuar një Komision lidhur me mbikqyrjen e shpronësimit në Sibofc, të lagjes Mexhuani dhe Konxheli dhe kisha me kërkuë që në mbledhjen e Kuvendit, Komisioni ta bëjë një raport deri ku kanë mbërrirë dhe deri ku mendohet se kjo problematikë është kryer.

**Sami Ahmeti** – Në këtë javë kemi pasë mbledhje të prindërve me nxënësit që i kemi në shkollën në Milloshevë. Kjo shkollë është 3 kate, dhe u tha se vetëm në katin e poshtëm funksionon uji ndërsa, nga kati i dytë e më lartë mbi 500 nxënës i shfrytëzojnë vetëm 2 toaletet poshtë. Ne kishim pasë dëshirë me pasë një përgjegje të saktë nëse, vërtetë është kështu sepse edhe unë e pashë se faktikisht është ashtu, jo për të bërë kritikë, por vetëm për tu përgatitë se nuk është në rregull kjo si e tillë. Po ashtu, u tha se nuk është e rregulluar çështja e nxemjeve, që çdo dimër po përsëritet si çështje. Pyetja e dytë ka të bëjë me QKMF-në, në Obiliq, përkatësisht sektorin e stomatologjisë, i cili së paku qe 3 muaj e ka një mungesë për shkak të një aparature diçka dhe askush nuk mund të kryej punë për rregullimin e dhëmbëve si dhe çështje të tjera. Këtë e kam të konfirmuar edhe prej drejtorit i cili më ka tregue se është në procedurë të tenderimit, por gjithsesi kisha pasë dëshirë derisa kanë shkuar muaj të tërë dhe kisha pasë dëshirë që deri në ditën e seancës me na dhënë një përgjegje deri ku ka shkue dhe pse duhet të pritë aq gjatë.

**Arben Berisha** – Në seancën e fundit jemi zotue për raportin e pronave dhe këtu, e kemi edhe Komisionin që është adekuat për këtë çështje. Komisioni e ka një kërkesë nëse, aprovohet por pa na ardhë me shkrim ne nuk kemi mund me i kërkuë Komisionit që me pasë.

**Ali Krasniqi** – Unë jam Kryetar i Komisionit për monitorimin e kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim. Ne e kemi dorëzuar një raport 6 mujor të këtij viti dhe çdo gjë është e specifikuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Ju keni kërkuar një raport specifik dhe ne kërkojmë prej juve që ky raport të vjen në 6 mujorin e dytë të këtij viti. Nëse, është e mundur me na pranue kërkesën tonë në mënyrë që mos të dalim disa herë në terren për këtë çështje..

**Enver Gashi** – Në një formë është kërkesë e Drejtorisë dhe ne jemi dakord, por mos po bëhet pak tepër sepse atëherë nëse, bëhet në janar nuk është raport 6 mujor, por është raport vjetor. Po ashtu, edhe ky rekomandim a është rekomandim edhe i Drejtorisë apo vetëm i Komisionit.


**Sami Ahmeti** – Unë e kuptova kërkesën e z.Krasniqi, dhe më duket e arsyeshme për faktin se me shkue disa herë te një person që e ka marrë organizata, apo kush e ka marrë atë pronë, me shkue brenda një viti 3 herë besoj se nuk është në rregullë për imazhin tonë. Pronat janë aty dhe nuk ka ndonjë telashe edhe nëse bëhet në fund të vitit, por në fund të vitit le të jetë raporti i specifikuar ashtu qysh e kemi biseduar. Unë mendoj

kështu, por prapë se prapë nuk ka dëm prej raportimit ,vetëm të mos krijojmë një qasje shumë të mundimshme edhe në raport me ata që iu kanë dhënë pronat. Unë jam i zëshëm në drejtimin e pronave, por jo edhe me iu marrë të drejtat njerëzve dhe me shkue vazhdimisht se a ke arritë, apo nuk ke arritë, kështu që 2 herë në vit është i mjaftueshëm me dhënë raport dhe raporti i ardhshëm le të jetë më i specifikuar.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan DPUKP-së dhe Zyres ligjore kërkesën nr.-I-27766/2023, e dt.20.09.2023, nga Kreshmik Balaj që në mbledhjen e Kuvendit Komunal Drejtoria në fjalë si dhe Zyra ligjore të vijë me një sqarim dhe ti njoftojnë anëtarët e Kuvendit Komunal.

Mbledhja përfundoi në ora 11:44'

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

